



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“ADVAN TECH” SH.P.K.

Numri i biznesit - 810173229

Pronar – Bashkim HAJRA & Oltjon BUSHI

Operator i Shpërndarjes “ADVAN TECH SHPK”

Platforma: IPTV

Prishtinë



## VE N D I M

për licencimin e Operatorit të Shpërndarjes, “ADVAN TECH SHPK”, sipas platformës IPTV,  
me seli në Prishtinë

### Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj, në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (Rregullorja KPM-2016/01) përcakton rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve, pavarësisht nga teknologjia e përdorur.
3. Kandidati “ADVAN TECH SHPK” ka aplikuar për licencë të KPM-së, për operatorë të shpërndarjes sipas platformës IPTV, më datën 3 maj 2020.

### Arsyetim

4. Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin i Pavarur për Media, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.
5. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”*.

6. Më datën 4 nëntor 2020, Departamenti i Licencimit, përmes telefoni ka kontaktuar të gjithë ata që janë licencuar në takimin e Komisionit të mbajtur më datën 30 tetor 2020, gjithashtu edhe përfaqësuesin e operatorit të shpërndarjes ADVAN TECH SHPK dhe i ka ftuar që të vijnë në Zyrën Ekzekutive të KPM-së për tërheqjen e vendimit për licencim, shkresën lidhur me tarifën e parë vjetore të licencës si dhe fturën për pagesën e kësaj tarife.
7. Më datën 5 nëntor 2020, në Zyrën Ekzekutive të KPM-së është paraqitur përfaqësuesi i operatorit të shpërndarjes ADVAN TECH SHPK për ti tërhequr dokumentet e cekura më lartë, mirpo i cili ka refuzuar pranimin e tyre, edhe pas konsultimit të tijë, përmes telefoni, me njërin nga pronarët, me arsyetimin e shumës së lartë për tarifë vjetore të licencës dhe se nuk ka qenë i informuar për tarifën.
8. Më datën 11 dhjetor 2020, Departamenti i Licencimit, përmes e-mail-i i ka përcjellë vendimin për licencimin e operatorit të shpërndarjes ADVAN TECH SHPK dhe njëherit i ka udhëzuar sërish përfaqësuesit e tij që, brenda një kohe të shkurtë kohore, të vijnë në Zyrën Ekzekutive të KPM-së, për tërheqjen e dokumenteve të cekura më lart në këtë rekomandim.
9. Më datën 23 dhjetor 2020, përmes të njëjtit e-mail përfaqësuesi i operatorit të shpërndarjes ADVAN TECH SHPK, ka konfirmuar se pronari i këtij operatori do të vijë në Zyrën Ekzekutive të KPM-së, me datën 29 dhjetor 2020, mirpo që kjo nuk ka ndodhur.
10. Komisioni vlerëson se, ADVAN TECH SHPK, përfundimisht ka dështuar të veproj sipas udhëzimeve të KPM, për tu pajisur me Pakon e Licencës të KPM-së dhe se në këtë mënyrë, nuk ka shprehur interesim që të ushtroj aktivitetin e shpërndarjes së shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale.

### Vendim

11. Komisioni në takimin e tij të mbajtur më datën 28 janar 2021, merr vendim për ndërprerjen e vendimit për licencimin e operatorit të shpërndarjes ADVAN TECH SHPK, vendimi me numër të referencës 2011/850/KPM/xh.l., për arsyet e cekura më lartë.
12. Komisioni vendos që, qështja e obligimeve finaciare e ADVAN TECH SHPK ndaj KPM-së të trajtohet në pajtim me Legjislacionin në fuqi.
13. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.

  
\_\_\_\_\_

Xhevat LATIFI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



28.01.2021

datë